



A.nr.284/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.284/2026, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga ankuesi N.D. nga Zubin Potoku, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar sipas nenit 6, paragrafi, 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e këshillimit dhe votimit më datë 22.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.284/2026, e datës 12.03.2026, e parashtruar nga ankuesi N.D.

**II. Anulohet** Vendimi Nr. 266/2026, i datës 04.02.2026, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ankuesin N.D. ta kthejë në pozitën e punës sipas aktit të emërimit të datës 11.01.2016, më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, përfshirë kompensimin e pagave të ndaluara sipas vendimit të anuluar si më pikën II të dispozitivit.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra në kuptim të zbatimit të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi N.D.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), përmes postës më datë 09.03.2026, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 12.03.2026 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.284/2026, kundër Vendimit me Nr. 266/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.04.2026 ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 1287/2026, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.03.2026; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 12.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 10.04.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Vendim me numër protokolli Nr.266/2026 të datës 04.02.2026; Akt emërimi i N.D me numër Nr.34, e datës 29.12.2015; Vendim për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil me numër protokolli Nr.2393/2025 e datës 31.12.2025; Përshkrimin e detyrave të punës; Diplomën me numër Nr.552, e datës 26.12.2011; Akt emërimi i B.K me numër Nr.Ref.DSP7/13, i datës 22.08.2013; Diplomën me numër Nr.103/11, e datës 27.07.2011; Akt emërimi i G.E me numër Nr.Ref: DMK-01-2020, i datës 15.07.2020; Certifikatë e datës 13.01.2022; Ndryshim i aktit të emërimit të D.G, me numër Nr.369, i datës 26.05.2014; Vendim për themelimin e komisionit me numër protokolli nr.104/2026, i datës 19.01.2026; Ndryshim i aktit të emërimit të D.G, me numër Nr.559/1, i datës 12.09.2014; Vendimi i KPMSHCK-s A.nr.108/2025, të datës 19.03.2026.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

#### *Gjendja e çështjes*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

-Ankuesi sipas Akt emërimit të datës 11.01.2016, është i punësuar në pozitën e punës *Administrator teknik për kontrollin e mirëmbajtjes* në Departamentin për Standarde të Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare(DSPIMNQ), pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

-Sipas Vendimit Nr. 2393/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi është transferuar përkohësisht në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve në Pejë, Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve, Agjencia e regjistrimit Civil/MPB.

- Lidhur me mos paraqitjen në punë të ankuesit si rezultat i Vendimit me Nr. 2393/2025 të datës 31.12.2025, organi i punësimit më datë 23.01.2026 ka iniciuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më supozimin se ankuesi ka kryer shkelje të rëndë disiplinore.

- Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më Vendimin 266/2026, të datës 04.02.2026, ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.4 dhe 4.10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht “ *mos përmbushje e detyrave të punës*”; “*moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale*” dhe “ *braktisje e punës ose mungesa të paarsyeshme dhe të vazhdueshme për tri (3) apo më shumë ditë*”, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

### *Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin Nr.266/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke pretenduar se parashtrimi i ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pezullon efektet e zbatimit të vendimit për transferim Nr.2391/2025, të datës 31.12.2025. Me tej shton se vendimi i kontestuar mbulohet nga shkelje të qenësishme procedurale sipas nenit 10, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) 01/2024 për Disiplinën e Zyrtarëve Publikë, duke pasur parasysh se vendimi i kontestuar e la të panjohur cilësinë e anëtarëve të Komisionit disiplinor. Nga ana tjetër, ankuesi konsideron se është shkelur Ligji për Procedurën Administrative, sepse vendimi është marrë në kundërshtim me nenin 48. Arsyeimi i aktit administrativ vetëm i paraqet "faktet e vërtetuara" në mënyrë kronologjike, d.m.th. emailt e NJMBNJ-së drejtuar eprorit të drejtpërdrejtë dhe komunikimin e tyre, pa asnjë pjesë të arsyesimit që kundërshton provat (përfshirë korrespondencën zyrtare). Propozon që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të aprovojë ankesën si të bazuar dhe të anulojë vendimin e kontestuar nr.266/2026 të datës 04.02.2026 si të pabazuar.

### *Përgjigje në pretendimet ankimore*

Ministria e Punëve të Brendshme përmes përgjigjes në ankesë të datës 10.04.2026, kundërshton pretendimet ankimore të ankuesit, duke theksuar se vendimi për transferim, nuk është anuluar, nuk është shfuqizuar e as nuk është pezulluar nga organi kompetent e për rrjedhojë, ai ka qenë akt administrativ i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm, i cili ka prodhuar efekte juridike dhe ka qenë detyrues për zbatim, prandaj, ankuesi ka qenë i obliguar të paraqitet në vendin e ri të punës deri në një vendimmarrje përfundimtare. Përbërja e Komisionit disiplinor ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk ekziston asnjë shkelje procedurale që do ta bënte vendimin të paligjshëm. Me tej, shtohet se pretendimet e ankuesit lidhur me ligjshmërinë e vendimit për transferim janë objekt i një procedure tjetër administrative dhe nuk përbëjnë çështje që ndikon në vlefshmërinë e procedurës disiplinore, përderisa vendimi për transferim ka qenë në fuqi dhe i ekzekutueshëm në kohën e ndodhjes së shkeljes disiplinore. Ligjshmëria eventuale e transferimit nuk e justifikon moszbatimin e një vendimi administrativ në fuqi. Propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kontestuar.

### *Vlerësimi i Kolegjit*

Në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar në ankesë në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje juridike-administrative dhe si rrjedhojë vërtetoi se akti i kontestuar nuk bazohet në vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikim të drejtë të ligjit material, mbi arsyet se ankuesi më datë 26.01.2026 ka parashtruar ankesë në KPMSHCK kundër Vendimit Nr.2393/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më të cilin akt ankuesi ishte transferuar në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve në Pejë, Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve, Agjencia e regjistrimit Civil/MPB, andaj, me ngritjen e ankesës si mjet i rregullt juridik, ky vendim nuk ka mundur të behët i ekzekutueshëm, pasi që nuk janë përmbushur kushtet ligjore sipas nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), ku parashihet: 1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit

*pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës..”.*

Rrjedhimisht, parashtrimi i ankesës ndaj vendimit për transferimin e ankuesit ka efekt pezullues siç përcaktohet me nenin 130 paragrafi 1 të LPPA-së, *1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”,* duke nënkuptuar së Vendimi Nr.2393/2025 i datës 31.12.2025, nuk mund të zbatohet dhe nuk krijon efekte juridik deri në marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë ankimore. Andaj, mbi këtë bazë, Komisioni Disiplinor i MPB ka dështuar në përcaktim të saktë të përgjegjësisë disiplinore së ankuesit, sepse, mbi ekzistimin e këtyre rrethanave ligjore, ankuesi mund të mbahet përgjegjës vetëm për shkelje disiplinore ndërlidhur me vendin e punës sipas aktit të emërimit të datës 11.01.2016.

Kolegji thekson faktin se instituti i veprimit pezullues të ankesës konsiston në garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërisë legjitime, në atë mënyrë, që pala ankuese të këtë mbrojtje nga pasojat që mund të jenë të pariparueshme dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese.

Në fakt, KPMSHCK-ja përmes kërkesës në përgjigje në ankesë, ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me efektin pezullues të ankesës ndaj Vendimit me Nr. 2393/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kështu që, nuk gjejnë mbështetje arsyetimet e organit punëdhënës si në përgjigjen në ankesë,

Thënë si më sipër, gjegjësisht, nisur nga konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se vendimi i kontestuar është akt administrativ i nxjerrë më vërtetim jo të drejtë të gjendjesh faktike dhe zbatim të gabuara të ligjit material, andaj, si i tillë është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vend.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.284/2026

**Merlinda Ramaj**

Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.D;

- MPB: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe

- Arkivit të KPMSHCK-së.